Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

L.Anr.1112/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Hasan Shala, Fejzullah Rexhepi, Rafet Haxhaj, Nenad Lazić, Ymer Hoxha, Afijete Sada - Gllogjani, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Strahinja Spasic, kandidatit për Kryetar të Komunës së Kllokotit, nga subjekti politik Lista Serbe, dega në Kllokot, lidhur me parregullsi në procesin e numërimit të votave të dërguara me post, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale te mbajtura me 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 27.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Strahinja Spasic, kandidatë për Kryetar të Komunës së Kllokotit, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, dega në Kllokot, me shenjën ZL.Anr.1112/2017, të datës 24.11.2017, paraqitur lidhur me parregullsi në procesin e numërimit të votave të dërguara me post, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19.11.2017, për Kryetar të Komunës së Kllokotit.

A r s y e t i m

Më datën 24.11.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë me numër ZL.Anr.1112/2017, të parashtruar nga Strahinja Spasic, kandidat për Kryetar të Komunës së Kllokotit, nga subjekti politik Lista Serbe dega në Kllokot, me të cilën ka theksuar se me datë 23.11.2017, diku rreth orës 16:30 kur është bërë numërimi i votave me kusht që kanë ardhur me post nga Republika e Serbisë, për Zgjedhjet për Kryetar të Komunës së Kllokotit,nga zyrtarët e QNR-së si dhe nga vëzhguesit është konstatuar se 19 fletëvotimet kanë qenë identike, të plotësuar me laps kimik nga një person ku pastaj është bërë kopja e fletëvotimeve dhe janë dërguar me 19 zarfe nga vendet e ndryshme në emër të personave të ndryshëm. Ankuesi pretendon se19 fletrvotime me kusht që kanë ardhur me post nga Republika e Serbisë, janë të falsifikuara dhe si të tilla ka kërkuar të anulohen .

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, ka bashkangjitur deklaratat e vëzhguesve me shkrim si dhe deklaratat e personave që kanë deklaruar se kanë votuar Listen Serbe.

Në përgjigje në ankesë të datës 25.11.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka theksuar se: Në bazë të nenit 6 dhe 7 të Rregullës Zgjedhore për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, dhe Rregullës 03/2013 për votim jashtë vendit, QNR-ja bënë verifikimin e zarfeve dhe

fletëvotimeve me kusht dhe zarfeve të fletëvotimeve përmes postës,ku së pari konstaton se a janë në përputhje me Rregullën për Votim Jashtë Vendit Nr. 03/2013 si dhe Rregullës zgjedhore të QNR-së. Po ashtu Sekretariati-Njësia e Votimit jashtë Kosovës i dorëzojnë zarfet e fshehtësisë të konfirmuara me shënimet për identifikim të bashkangjitura dhe të klasifikuara në bazë të komunave, te Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Pastaj QNR-ja, më pas i procedojë zarfet dhe fletëvotimet e votuesve Jashtë Kosovës, në bazë të dispozitave të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr.06/2013 mbi QNR-në.
KQZ-ja, në vazhdim ka shtuar se i gjithë dokumentacioni i votimit përmes postës mund të ofrohet për hetim, verifikim apo konstatim të gjendjes faktike nga PZAP-në dhe organet e drejtësisë.

Me datë 26.11.2017 subjekti politik Lista Serbe ka paraqitur në PZAP kërkesë për tërheqje të ankesës.

PZAP-i lidhur me kërkesën e subjekti politik Lista Serbe ka njoftuar ankuesin Strahinja Spasic, i cili në përgjigjen e dhënë me datë 26.11.2017, ka theksuar se mbetet pranë ankesës së tij, si dhe ka potencuar se subjekti i tij Lista Serbe i ka bërë presion atij që të heq dorë nga kandidatura, dhe ka kërkuar nga ai që të tërheq ankesën mirpo ai me këtë nuk është dakorduar dhe ka propozuar që të procesohet ankesa e tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe vlerësimit te provave te bashkngjitura ne ankesë në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli me qëllim të hetim, dhe verifikim të pretendimeve ankimore përkitazi me parregullsitë e fletëvotimeve me datën 26.11.2107, ka angazhuar ekipin hetues të PZAP-së, për të zhvilluar hetimet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), konform Nenit 14 të Rregullës nr.02/2015 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së, i cili përcakton se ;" *Kur PZAP-i pranon një ankesë që konsiderohet të jetë e rregulltë, dhe kur një ankesë e tillë është e dyshuar për veprimtari mashtruese që përfshin materialin zgjedhor, Paneli vendimmarrës do të autorizoj një anëtar të panelit, si hetues kryesor si dhe zyrtarin ligjor të ngarkuar në çështjen konkrete që ti zhvilloj hetimet*".

Nga hetimi i bërë nga ekipin hetues i PZAP-së, në kutinë e votimit BM 137/001, është konstatuar se në kuti gjenden 19 zarfa të hapura. Këto zarfa kanë qen në tri lloje të ndryshme, nga të cilat 11 llojit të njëjtë, 5 llojit të njëjtë dhe 3 llojit njëjtë.Në kuti kanë qenë19 fletëvotime dhe në të gjitha fletëvotimet kanë qenë të plotësuara me lapës kimik me shenjën tik (✓), jo të kopjuara, për Bozhidar Dejanovoic kandidat nga subjektin politik GI Kllokot-Vrbovic, ndërsa kandidati Strahinja Spasic, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe nuk ka pas asnjë votë.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore vërtetoj se ankuesi nuk ariti që në mënyr të sigurt dhe bindëse ta vërtetoj pretendimet në anesë përkitazi me falsifikimin e fletëvotimeve të dërguara me post të arritura nga Republika e Serbisë. Ndërsa nga hetimi i bërë nga hetuesit e PZAPI-të, nuk rezulton e fletëvotimet janë të kopjuara.

Paneli me rastin e vendosjes në këtë rast ka marr parasysh edhe deklaratat e vëzhguesve dhe dëshmitarëve te bashkangjitura ne ankesë të cilët në deklaratat e deponuara pohojnë se të gjitha fletëvotimet kanë qenë të kopjuara, Paneli deklaratat e tilla i cilësoj si pa ndikim në marrjen e vendimit në favor të ankuesit për faktin se deklaratat e tilla janë në kundërshtim me të gjeturat e hetimit të bërë nga ekipin hetues i PZAP-së, në kutinë e votimit BM 137/001, ku është konstatuar se fletëvotimet nuk janë të kopjuara.

Rrjedhimisht, PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse pretendimet ankimore të ankuesit , konstaton se janë të pabazuara dhe të pa argumentuar, dhe si të tilla u vlerësuan se nuk i plotësonë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117.3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku është përcaktuar: " Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse ".

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117 dhe 118 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1112/2017 me datën 27.11.2017

Prishtinë / Priština

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës.*